

Deklaratë e përbashkët e Organizatave Mjedisore në Shqipëri

Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri, duan të shprehin publikisht shqetësimin e qartë në lidhje me masat, politikat dhe investimet që ndikojnë dhe kontribuojnë më tej në **degradimin e statusit mjedisor të zonave natyrore dhe urbane** në Shqipëri.

Krimi mjedisor është më shumë se kurrë i pranishëm dhe i vazhdueshëm në të gjithë Shqipërinë. Komuniteteve po u privohet e drejta për t'u përfshirë në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes, e si rrjedhojë pjesa më e madhe e ndërhyrjeve si nga autoritetet private, ashtu edhe nga ato publike mund të sjellin konflikte dhe përplasje midis komuniteteve.

Ndërkohë që komunitetet e kanë të vështirë të kanalizojnë shqetësimin e tyre, le të ndalemi për një moment dhe të imagjinojmë se sa e vështirë është që **ekosistemet natyrore dhe biodiversiteti të sigurojnë qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e burimeve të tyre**, pa patur përfaqësi nga të paktën një deputet në Parlamentin e Shqipërisë.

Duke patur parasysh natyrën e ndryshme të krizës me të cilën po përballemi, është e domosdoshme që publiku të marrë mesazhin se ka ardhur koha për të shtuar kritikën, për të izoluar propagandën dhe politikën e bërë në kurriz të mjedisit. Duke qenë se shëndeti publik, i ndjekur nga sektorë me rëndësi ekonomike kombëtare si energjia, bujqësia, turizmi, planifikimi hapësinor janë të gjitha nën presion të vazhdueshëm nga përkeqësimi, ndotja dhe ndryshimi i klimës, Shqipëria duhet të nxitojë të pozicionohet në mënyrë të qartë dhe strategjike kundër këtyre rreziqeve.

Komuniteti i OShC-ve Mjedisore kërkon të ngrejë zërin e kritikës në lidhje me gatishmërinë e papërfillshme që kanë autoritetet publike, private dhe komunitetet në lidhje me:

Klimën dhe Energjinë

- Forcimi i kapaciteteve të pushtetit vendor nëpërmjet ngritjes së strukturave përgjegjëse për çështjet klimatike.
- Mbështetja e kërkimit shkencor për të identifikuar ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe për të mbështetur vendimmarrjen zhvillimore.
- Zhvillimi i politikave sociale për të mbështetur shtresat në nevojë që preken drejtpërdrejtë nga pasojat e ndryshimeve klimatike.
- Përmirësimi dhe shtimi i alternativave të transportit publik.
- Zbatimi i tranzicionit energjetik në Shqipëri sipas parimeve të Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së.

Për sa i përket natyrës dhe habitateve, Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ-të) janë shumë të shqetësuara për **humbjen e habitateve dhe specieve në zonat kyçe të biodiversitetit** dhe në të gjithë vendin, si pasojë e aktiviteteve/vendimarrjeve të paqëndrueshme, përfshirë urbanizimin, intensifikimin e aktiviteteve industriale dhe bujqësore, etj.

OJQ-të e rrjetit të mbrojtjes së natyrës kërkojnë nga institucionet vendimarrëse që **çështja e ruajtjes dhe promovimit të biodiversitetit të jetë prioritet i vendit, të ndalohet vendimarrja e gabuar në zonat kyçe të biodiversitetit, të luftohet krimi mjedisor nga institucionet, të rritet transparenca dhe qëndrueshmëria në vendimmarrje dhe të forcohet bashkëpunimi me shoqërinë civile për një vendimarrje më të qëndrueshme dhe për një pjesëmarrje aktive në proceset e hartimit të ligjeve.**

Për ndotjen, kërkojmë:

- Krijimin e një platforme me të dhëna mjedisore në nivel lokal dhe kombëtar.
- Zbatimin e vendimmarrjes me pjesëmarrje të sanksionuar me ligj, përmes dëgjimeve publike.
- Planet tematike vendore të hartohen nga pushteti qendror dhe vendor, për menaxhimin e duhur të mbetjeve, ajrit, emergjencave civile, zhurmës dhe ujit.
- Zbatimin e “përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit”.
- Krijimin e një metodologjie monitorimi mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, duke iu nënshtruar një procesi konsultimi me shoqërinë civile.

Në përfundim,

Ne, komuniteti i OSHC-ve Mjedisore në Shqipëri jemi të shqetësuar nga mungesa e burimeve njerëzore dhe teknike që ka autoriteti kyç, si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në lidhje me përmbushjen e funksionit bazë të parashikuar nga legjislacioni kombëtar. Kjo situatë është edhe më e paqartë në rastin e agjencive dhe autoriteteve rajonale.

Zgjidhjet e paraqitura gjerësisht nga autoritetet kanë një kosto të lartë, por për më tepër nuk ofrojnë qëndrueshmëri. Duke marrë për shembull sektorin e energjisë, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbetjeve apo ndotjen e ajrit, ku ne jemi kampionë në neglizhimin e monitorimit dhe raportimit për këto çështje. Nga ana tjetër, sektori privat, i prirur nga neglizhenca e vetë agjencive publike për të respektuar detyrimet për të investuar në masat e mbrojtjes së mjedisit, gjen terren të përbashkët për të anashkaluar me sukses çdo detyrim të parashikuar nga legjislacioni për zbutjen dhe respektimin e standardeve në lidhje me parandalimin dhe trajtimin e ndotjes.

Për referencë, në Tiranë janë mbi 200 mijë qytetarë të të gjitha moshave, grupeve, gjinive dhe përkatësive që janë të ekspozuar ndaj zhurmave jashtëzakonisht stresuese, mbi 3 mijë njerëz në Shqipëri vdesin para kohe çdo vit nga ndotja e ajrit.

Kërkojmë që **mjedisi** sa më shpejt të jetë një nga **pesë prioritetet e agjendës së politikës kombëtare**. Është koha për të ndaluar propagandën dhe politikën në kurriz të mjedisit, është koha që mjedisi të respektohet brenda kornizës së tij fiziko-kimike dhe të ekosistemit.

Më e rëndësishmja, i kërkojmë publikut të reflektojë dhe të japë një mendim të dytë përpara se të zgjedhë përfaqësuesit e tij.

Ne ndajmë shëndetin dhe prosperitetin tonë me mjedisin, jo me politikën.

Kujdesuni për shëndetin tuaj dhe të brezave që do të vijnë, duke qenë kritikë dhe duke mos marrë pozicione ekstreme pro e kundër apo kuq e blu!

Ne, mbi 48 OSHC, jemi në dispozicion për t'ju ndihmuar në çdo kohë për të adresuar shqetësimet tuaja, ose një krim mjedisor që po ndodh pranë jush. Ndaj, jemi këtu sot për të thënë atë që shumica e autoriteteve jo vetëm në Shqipëri, por kudo në rajon dhe më gjerë, ngurrojnë ta përmendin.

Ne si shoqëri civile, por si qytetarë mbi të gjitha, duam të themi **STOP**.

Ne nuk duam të trashëgojmë kriza nga një sistem në tjetrin, nga një brez në tjetrin. Ne duam të angazhohemi dhe sakrifikojmë për zgjidhje të qëndrueshme.

Tiranë, 5 maj 2022

Forumi Kombëtar i Mjedisit



Aneks 2 – Agjenda



5 Maj 2022 / 09:30 - 13:30
Rogner Hotel Tirana

9:30 - 10:00

Regjistrimi i pjesëmarrësve

10:00 - 10:25

Fjala përshëndetëse

Znj. Elsa Håstad
Ambasadorja e Suedisë në Shqipëri

Z. Dritan Shutina
Drejtori ekzekutiv i Co-PLAN

Z. Rodion Gjoka
Menaxher i projektit Green-AL

10:25 - 11:00

Prezantim i partneriteteve Green-AL

Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit
Eco Partners për Zhvillim të Qëndrueshëm
Ekologët për Rajonin Kukës
Forum i Shqiptar Liqeni i Shkodrës
Edukim Komunitar për të Drejta, Kulturë dhe Integrim

11:00 - 11:30

Pushim Kafe

11:30 - 13:00

Forume Tematike

Ndryshimet Klimatike dhe Energjia
Ndotja e Mjedisve Urbane dhe Natyrore
Promovimi dhe Mbrojtja e Habiteteve

13:30

Deklaratë mbi pozicionimin e përbashkët të organizatave mjedisore në Shqipëri



Aneks 3 – Organizatat nënshkruese të deklaratës

- 1) Co-PLAN - Instituti për Zhvillimin e Habitatit;
- 2) COSV Albania - Cooperazione per lo Sviluppo;
- 3) CISP-Sviluppo dei Popoli VIS Albania;
- 4) VIS Albania - Volontariato Internazionale per lo Sviluppo;
- 5) AOS – Shoqata Ornitologjike e Shqiperisë;
- 6) Forumi i Mendimit të Lirë;
- 7) Agri-En - Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore;
- 8) MENV Group – Vlerësim mjedisi, Energji, Natyrë
- 9) Shoqata Ekologët për Rajonin;
- 10) Shoqata Blini;
- 11) CERCİ-Edukimi Komunitar për të Drejtat, Kulturë, Integrim;
- 12) Eco Partners for Sustainable Development;
- 13) EDS Foundation;
- 14) ETMI - Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit;
- 15) IEP -Instituti i Politikave Mjedisore
- 16) Federata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Qarku Kukës;
- 17) Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës;
- 18) Vizioni i Gjelber;
- 19) Milieukontakt Shqipëri;
- 20) H2H Foundation;
- 21) Shoqata ALPIN;
- 22) INLSH - Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri;
- 23) INCA - Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri;
- 24) OMP - Organizata e Menaxhimit të Peshkimit;
- 25) Organizata Miqësia Ulëz;
- 26) MMZHT - Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit;
- 27) Eco Albania – Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri;
- 28) North Green Association;
- 29) New Bridges;
- 30) Nisma e Luleve;
- 31) New Impact;
- 32) QSNN - Qendra Sociale në Ndhimë të Njerëzve në Nevojë;
- 33) RCDC - Qendra për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal
- 34) CSDC – Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile;
- 35) REC Shqipëri – Qendra Burimore e Mjedisit;
- 36) TFL – Together for Life;
- 37) ASTER – Shoqata për Turizmin e Qendrueshëm dhe Kërkimet Mjedisore;
- 38) EPER Center - Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim;
- 39) RURAL;
- 40) SDI - Social Development Investment;
- 41) Well Point – Kujdes për të gjithë;
- 42) GO2 Albania;
- 43) Flag Pine organization;
- 44) Qendra JOBIS;
- 45) KMT - Këshilli Mjedisor Tiranë;
- 46) Mjedisi dhe Komuniteti;
- 47) ASP - Akademia e Studimeve Politike;
- 48) MKEZH - Shoqata "Multifunksionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim.

Aneks 4 – Protokollet

Drejtuar:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Nr. 1993 Prot, Datë 23.03.2023

Agjensia Kombëtare të Mjedisit

Nr. 2048 Prot, Datë 23.03.2023

Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Nr. 1080 Prot, Datë 23.03.2023

Aneks 5 – Versioni i përkthyer i deklaratës

Joint statement by the Environmental Organizations in Albania

Environmental Civil Society Organizations in Albania, publicly want to state an explicit concern with regard to measures, policies and investments which are affecting and further contributing to the degradation of the environmental status of natural and urban areas in Albania.

Environmental crime is more than ever present and persistent across Albania. Communities are being deprived of the right to be involved in planning and decision-making processes, as a result most of the interventions both from private and public authorities are inclining conflict and clash between and among communities.

While communities find it difficult to channel their concern, let us pause for a moment and imagine how difficult it is for natural ecosystems and biodiversity to ensure the sustainability and continuity of their resources without being at least represented by one MEP in Albania.

Given the diverse nature of crisis we are facing, it is imperative for public to absorb the message that the time has come to increase criticism in order to segregate propaganda and politics made at the expense of environment. Since public health, followed by sectors of national economic importance such as energy, agriculture, tourism, spatial planning is all under a constant pressure from deterioration, pollution and a changing climate, Albania must rush to position itself appropriately and strategically against these risks.

The Environmental CSO community seeks to raise the voice of criticism in relation to the negligible readiness that public, private authorities and communities have in relation to:

Climate and Energy:

- Strengthening the capacity of local government through the establishment of structures responsible for climate issues.
- Support research to identify the impacts of climate change and support development decision-making.
- Development of social policies to support the needy who are directly affected by the consequences of climate change.
- Improving and increasing public transport alternatives.
- Implementation of the energy transition in Albania according to the principles of the EU Green Deal.

Regarding **nature and habitats**, NGOs are very concerned about the loss of habitats and species in key biodiversity areas and throughout the country as a result of unsustainable activities / decision-making, including urbanization, intensification of industrial and agricultural activities, etc.

The NGOs of the nature protection network demand from the decision-making institutions that the issue of preservation and promotion of biodiversity be a priority of the country, to stop wrong decision-making in key biodiversity areas, to fight environmental crime by institutions, to increase transparency and sustainability in decision-making and to strengthen cooperation with civil society for a more sustainable decision-making.

For the **pollution**, we demand:

- Creating a platform with environmental data at the local and national level.
- Implement participatory decision-making sanctioned by law through public hearings.
- Thematic local plans are drafted by the central and local government, for adequate management of waste, air, civil emergencies, noise, water.
- Implement extended manufacturer liability.
- Establish an environmental monitoring methodology by the National Environmental Agency by undergoing a consultation process with civil society.

In conclusion,

We the community of Environmental CSOs in Albania are concerned by the disturbing lack of human and technical resources that the key authority, such as Ministry of Tourism and Environment has with regard to fulfilling basic function provided by national legislation. This situation is even worse when considering the agencies and regional authorities.

The solutions widely presented by the authorities come at a high cost but moreover do not offer sustainability. Taking for example the energy sector, wastewater treatment, waste management or air pollution where we are champions in neglecting monitoring and reporting on this issue. On the other hand, the private sector, inclined by the negligence of the public agencies themselves to respect the obligations to invest in environmental protection measures, thus they find common ground to successfully bypass any obligation foreseen by legislation to mitigate and respect standards with regard to pollution prevention and treatment.

For reference, in Tirana there are over 200'000 citizens of all ages, groups, genders and affiliations who are exposed to extremely stressful noises, over 3'000 people die prematurely every year in Albania due to air pollution.

We demand that as soon as possible the environment comes as one of the five priorities of the national policy agenda. It is time to stop propaganda and politics at the expense of environment, it is time that environment is respected within its physics-chemical and ecosystems framework.

More importantly, we ask the public to reflect and give a second opinion before choosing representatives. We share our health and prosperity with the environment not with politics, take care of your health and the generations to come by being critical and not taking extreme Pro-Cons or Red-Blue positions!

We are over 48 CSOs available to assist you at any time in addressing your concerns or an environmental crime that is happening near you. So today we are here to say what most authorities not only in Albania, but everywhere in the region and beyond are reluctant to mention.

We as civil society, but as citizens above all want to say STOP.

We do not want to inherit crises from one system, from one generation to the other, we would rather commit and sacrifice for resilient solutions.

Tirana, May 5th 2022

National Environmental Forum